

# Oral History Kosovo

---

**Narratorja:** Para se me met shtatzanë kom punu me kqyr ni fëmijë. Edhe u konë fëmija, çika e ni shoqes, i ka pasë gjashtë muj. Edhe prej gjashtë mujve më thirri në telefon tha, “Duhna patjetër me dalë në punë, a munësh me ardhë?” Thashë, “S’jom mësu me fëmijë kaq të vegjël” thashë, “tutna” u tutsha. “Jo, po s’ muj me ja besu kërkujt fëminë veç ty”. “Hajt” thashë, “se po vi, veç ta kesh parasysh me bo mos me mujt, mos u liro me ato se e gjeta dikon” thashë, “se muj mos me mujt, tutna ose diçka” thashë, “edhe duhna m’u tërhjekë”.

**Intervistuesja:** E çka të tutke?

**Narratorja:** E vogël, thojsha mos p’e vraj ose nuk di me ushqy, p’e plasi. U tutsha, qekjo u tutsha. Po diqysh u mësova menihere. M’u duke asi duq fëmije, i vogël duq. Po edhe pse une shkova me kqyr veç çikën, vet qasi natyre e kom që s’ muj me nejt ni ven. Si flejke ajo, u çojsha fshijsha diçka, bojsha diçka edhe pse nuk e kisha obligim, po isha mësu me ato me fshi ose mos me mujt me pa qato qaty keq edhe u çojsha. Masanej unë fillova me u marrë edhe me punët e shpisë.

**Intervistuesja:** Sa orë të bike me qenë aty?

**Narratorja:** Prej 08:00 në mëngjes deri në ora 16:00.

**Intervistuesja:** Sa u pagujshe për ato orë?

**Narratorja:** 200 euro.

**Intervistuesja:** Për ni mujë?

**Narratorja:** Po.

**Intervistuesja:** Pesë ditë në javë.

**Narratorja:** Gjashtë edhe të shtunën. Ka pasë raste kur të shtuneve s’jom shku. Najherë e ka çu te prindët e vet, amo pjesën ma të madhe, po edhe të shtunën. E pozitiviteti u konë qeky se jom mësu me fëmijë. E kom pa që nuk osht’ bash punë e fshtirë me fëmi, amo osht’ punë delikate.

**Intervistuesja:** Çka bojshe me fëmi, kur nuk flejke po meno, kohën e lirë qysh e kalojshe?

**Narratorja:** Ajo e vogël, gjashtë mujsh, u munojshe me ja knu do kongë që na i dishëm kur jena konë të vegjël me shti në gjumë. I jepsha me hongër, e ka pasë ni orar të vetin të caktum edhe ushqimin u deshke...

**Intervistuesja:** Orarin e ki kriju ti, a nana vet?

**Narratorja:** Jo, nana vet. Une veç ju përmbajsha qati rregulli. E pregaditsha ushqimin me atë blenderin ato, i jepsha me hongër. Ajo u konë shumë fëmijë i marë, kohën e gjumit ka flejt, krejt senet i ka pasë me orar. Si me kurdisë, çu, çohu, flej, flej. Nuk e di, nuk e kom pasë hiç fshtirë m'u marrë me to. Përrjashtim nëse u konë smutë, dy herë më ka ra smutë me konë, osht' normal. Fëmija kur jonë smutë janë pak ma... na të mëdhejtë kur jemi smutë i kemi do farë tekesh tona, e le mo fëmija.

E kur u konë smutë, tanë kohën t'u e thirrë nanën e vet, "E çka m'i dhonë qetash, e çka m'i bo?" Se u tutsha me marrë ni vendim une për fëminë e huj. Pak nashta ja tesha tu e thirrë, po s'kisha çka me bo se s'guxojsha. Edhe ku p'e dinë për fëmiun munet m'u konë alergjik ose diçka mos me ja pranu trupi. Po në përgjithësi u konë fëmi i mirë. Jom marrë shumë me to, e kom dashtë shumë. Nisa m'u lidhë shumë me to, e ja nisi m'u lidhë me mu, e kaniherë kur vike nona e vet prej punës ma shumë rrike me mu, nuk i shkojke nonës vet hiç, ish lidhë prej meje.

Deri nonë mujë po më doket, kur i ka bo nonë muj ja kom nisë qaty kapak kishe po ngjyrosi me to. I kapke qeto i bojke do vija, do qesi sene. Thojsha veç m'u marrë me naj aktivitet, gjysë ore e kom pasë me ja lëshu televizorin, qashtu më ka thonë, gjysë ore e kqyrke televizorin, po kurrë s'e ka kqyr gjysë ore, meniherë e nxike gjumi tu e kqyr. Nashta që s'ò mësu me pa televizor edhe si ja niske me kqyr, flejke, e nxike gjumi. Kështu që, e mësova metodën me shti në gjumë, *tak* {onomatope} para televizorit (qesh) edhe ajo flejke. Edhe mirë, punë e mirë, pata mësu shumë mënyrën qysh me rritë ni fëmi, kom mësu shumë.

**Intervistuesja:** Sa kohë e ke rujt?

**Narratorja:** Dej i ka bo ni vjet, gjashtë muj.

**Intervistuesja:** Qysh u konë qajo faza kur u dashtë me lonë atë çikën e vogël që ke qenë tu e rujt edhe me vazhdu jetën?

**Narratorja:** Realisht unë e kom lonë, se s'kanë dashtë ata me më lonë, s'kanë pasë qef me çu në kopsht, kanë pasë qef m'u marrë unë me to. Se unë fillova pak me u marrë me aktivitete me to, kisha qef me mësu kapak. Edhe ja nisa me mësu me ecë e këto gjana. Realisht krejt kohën unë e kalojshe me

to edhe... Po masnej une meta shtatzane edhe e kom pasë ni shtatzani me probleme e që s'mujsha mo me vazhdu me punu. Ato ma ndaloi doktori, realisht më tha se, "Duhesh me nejt në shpi". Edhe qekjo u konë arsye që e kom ndërpre, se nuk e kisha ndërpre, bile deri sa të kisha mujt jo. Për dy parët, për tri parët u konë fshtirë, edhe për mu edhe për prindët, edhe për çikën.

Po jom munu gjithmonë me nejt në kontakt me to, e shoh kaniherë edhe tash, u rritë tash. Po diqysh tash s'më njeh sikur atëherë, tash ma ndryshe. Kaniherë edhe kur t'i foli pak largohet, tutët, a din, nifarë... Po u konë shumë fshtirë edhe më ka mungu shumë në fillim, *auf* {onomatope}. Ka pasë rast nja dy herë edhe kom kajt, kur m'u kujtojke qysh çohet ajo në mëngjes, e çka bon, e qysh të lyp meniherë. E kur e disha që s'më sheh thojsha qysh osht' t'u kalu në kopsht tash. Po qe kur i ka bo ni vjet, ata e kanë çu në kopsht, une e kom ndërpre, s'kom vazhdu mo me shku. Përnime u konë e fshtirë, për fat të mirë s'jom da prej djalit tem, amo atëherë s'kom pasë fëmi tem, m'u ka dokë sikur kur dahesh prej fëmisë se u mësova me to, u lidha me to.